



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 60 datë 30.09.2024

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. MERITA SHEQERI, Z. FATBARDH BEQIRI, ZNJ. SEMIHA ÇELEPIJA, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit Nr.68/2017 “Për financat vendore” i ndryshuar, VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, VKB Nr. 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, VKB Nr 18, datë 29.04.2024 “Për shtesë në buxhetin e vitit 2024 e miratuar me “Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave Nr. 3806/1 prot., datë 29.03.2024, administruar pranë Bashkisë Shkodër me Nr.7115, datë 04.04.2024 dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Merita Sheqeri** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Merita Sheqeri** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 218 063 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Merita Sheqeri**.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Fatbardh Beqiri** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri .
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Fatbardh Beqiri** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 951 414 (nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e katërbëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 216 200 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Fatbardh Beqiri**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Semiha Çelepija - përfaqësuese ligjore e z. Arben Merlika** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njëzet mijë) lekë, për dëmtimin e banesës nga zjarri .
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Semiha Çelepija (përfaqësuese ligjore e z. Arben Merlika)** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 2 082 610 (dymilionë e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë, , dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 507 840 (pesëqind e shtatë mijë e tetëqind e dyzet) lekë , sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj.Semiha Çelepija**.
7. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024 të miratuar me VKB Nr 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë së Shkodrës” i ndryshuar, në programin **P03280, Q1 O1 A4** “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
8. Për familjet e **znj. Merita Sheqeri , z. Fatbardh Beqiri dhe znj. Semiha Çelepija** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a, VKB nr. 55, datë 29.12.2023, VKB nr 18, datë 29.04.2024 “Për shtesë në buxhetin e vitit 2024 e miratuar me “Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 55 datë 29.12.2023 “për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 1 626 043,5(një milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyzet e tre presje pesë) lekë dhe ne masen 50% të vlerës së orendive në shumën 362 020 (treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëzet) lekë .

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota

Vota Pro 39

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

